

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Lenis Intermediate, Inc., me seli të regjistruar në 1209, Orange Street, Wilmington, Delaware, 19801 Qarku New Castle, SHBA, përmes Shoqërisë së Avokatëve Debarliev Dameski dhe Keleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 01.08.2025, solli këtë

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin Lenis Intermediate, Inc., me seli të regjistruar në 1209, Orange Street, Wilmington, Delaware, 19801 Qarku New Castle, SHBA do të fitojë kontroll të vetëm mbi LENIS farmaceutika d.o.o, me adresë afariste në Litostrojska cesta 52, 1000, Lubjanë, Slloveni, edhe pse bie ndesh me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengim, kufizim apo shtrembërim të ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të konsiderueshme të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21) në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 14.07.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga Lenis Intermediate, Inc., me seli të regjistruar në 1209, Orange Street, Wilmington, Delaware, 19801 Qarku New Castle, SHBA, me të cilin Lenis Intermediate, Inc. do të fitojë kontroll të vetëm mbi LENIS farmaceutika d.o.o, me adresë afariste në Litostrojska cesta 52, 1000, Lubjanë, Slloveni.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe bashkëngjitjeve të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Lenis Intermediate, Inc. është një kompani holding e cila kryen aktivitete të shoqërisë holding, si veprimtari e vetme afariste. Lenis Intermediate, Inc. nuk ka aktivitete ekonomike dhe nuk ka të regjistruara shoqëri të varura në territorin e Maqedonisë së Veriut.

Lenis farmaceutika d.o.o ofron një sërë shërbimesh si distributor rajonal nga Sllovenia për barna të specializuara („niche“) dhe barna që jepen me recetë (barna me recetë), në Evropën Qendrore dhe Lindore. Përveç sigurimit të autorizimeve për vendosjen e barnave në treg, ajo menaxhon edhe forma të ndryshme të Programeve për Qasje të Hershme (EAP) dhe kryen import të barnave të pa licencuara, si dhe siguron zgjidhje për mungesën e barnave duke adresuar ndërprerjet e përkohshme në furnizimin me barna që përndryshe janë të disponueshme.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Lenis farmaceutika d.o.o ka një shoqëri të varur të regjistruar në pronësi të plotë – MEDIKOFARMACIJA SHPKNJP Shkup, me NUAS 5690781, me adresë të regjistruar në rr. Boris Trajkovski nr. 286, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut dhe veprimtari afariste të regjistruar 73.200 - Hulumtimi i tregut dhe sondazhi i opinionit publik.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ